



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3021/10 prot.,

Datë 18.11.2025

V E N D I M

Nr. 1709/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025 me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1619/2025, datë 07.11.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N, me adresë: Lagjja Kastrioti ,rruga Andon Profka ,2 kullat Fier.

Operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK me NIPT L79326502O, me adresë: Rruga Kosovareve, Rruga Ndreko Rino, Pallatet Viridario, Hyrja 1, Kati 3, Ap 35.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlore. Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”,Vlore, 9400.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 07.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1619/2025, ku vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr. 18931/1 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3021/7 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka përcjellur modifikim e dokumentave të tenderit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr.1619/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 18931/1 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3021/7 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka përcjellur modifikim e dokumentave të tenderit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr.1619/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen modifikimet sipas vendimit nr. 1619/2025 datë 07.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike konstatohet se autoriteti ka vijuar me publikimin e shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje të vendimit nr. 1619/2025, datë 07.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me

objekt: “Rikonstrukcion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

